



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 35

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 10 shtator 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1488, datë 3.9.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Alba Exotik Fruit sh.p.k.”..... 3
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1489, datë 3.9.2018	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Erald Meta, NIPT: L 81323022 O”..... 4
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 5981, datë 10.9.2018	Për pozicionin e lirë të Specialistit të Sekretarisë Gjyqësore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit..... 6
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 5982, datë 10.9.2018	Për pozicionin e lirë të Këshilltarit Ekonomik në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit..... 6

**KËRKESË****Nr. 1488, datë 3.9.2018****PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “ALBA EXOTIK FRUIT
SHPK”**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i

institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar: Largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. Alba Exotik Fruit sh.p.k.

**KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
Evisjon Salku**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT
DEGA RAJONALE E QARKUT TIRANË
VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT**

Nr. ISHMPU-TR-2018-000154 - 5

Datë: 17/08/2018

Bazuar në nenin 46 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit Nr. ISHMPU-TR-2018-000154 - 2, datë 20/07/2018, inspektim, që është zhvilluar në subjektin ALBA EXOTIC FRUIT, NIPT L12413011Q, Punëdhënës Jamarba Gjoka, prej datës 20/07/2018 00:00 deri më datën 20/07/2018 00:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë 20/07/2018 dhe e njoftoi në datë 20/07/2018. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: Ligji Nr.10 448 dt.14.07.2011 “Per lejet e mjedisit” 29 b/iii.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit Gjate kontrollit rezultoi se subjekti nuk ka plotësuar kushtin 4.1.4 të lejes mjedisore që mban duke mos kryer dhe dorezuar pranë ARM Tiranë raportin e informacion/monitorimit për zbatueshmerine e kushteve të lejes mjedisore dhe nuk ka kryer pagesen e tarifës vjetore për lejet e mjedisit sipas percaktimeve në lejen mjedisore që mban, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobe 300000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

=

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Genci Hicka ID: 0301020016

Inspektor ISHMP TR ID:

Aris Koroshi ID: 480402210E

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti ALBA EXOTIC FRUIT ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.



KËRKESË

Nr. 1489, datë 3.9.2018

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT "ERALD META, NIPT: L
81323022 O"**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i

institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar: Largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. Erald Meta, NIPT: L 81323022 O

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
Evisjon Salku

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE**

Nr. Serial: 0000329 Datë: 26/06/2018

PROÇES - VERBALI I INSPEKTIMIT

Në zbatim të nenit 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave", të ndryshuar, në kontrollin e ushtruar në subjektin:

Erald Meta NIPT: L 81323022 O
Aktiviteti dhe adresa e subjektit: Përpunimi dhe shërbime për outnjete
q: Tiranë, R: Tiranë, H: V. N. L. Bregu, Sautoriun, Nr. 57
në prani të: Erald Meta, me detyrë Administratur

Konstatova: Subjekti është mbajtur i një leje administrative: Po → ☐ Jo → ☒ ;

Tipi i Lejes Mjedisore ---, Nr. Identifikimit ---, datë ---

PËRSHKRIMI, GJETJET DHE SHKELJET ADMINISTRATIVE:

Në bazë të autorizimit të inspektorit nr. 1056 Prot. u. Ktye,
kontrolli në subjektin dhe kontrolli i ushtruar rezultoi se subjekti
uq. është nënshtruar të Lejes Mjedisore. Subjekti i kontrollit
detyrë të pajisur me leje Mjedisore të Tipit 5 brez. u. 20
q. tërë. uq. bazë të ligjit 10433 Për Lejet e Mjedisit uq. dyshuar
q. 11/07/2011

Personi përgjegjës

Specialisti

Inspektori i ISHMPU

i kontrolluar

Erald Meta

(Emër, mbiemër, firmë)

(Emër, mbiemër, firmë)

Rajona Mehmeti
Kajdi Ahmetaj

(Emër, mbiemër, firmë)

• Akti inspektimit mbahet në 4 (katër) kopje dhe sipas qëllimit të inspektimit përdoret:

1. Për kontrollin e përputhshmërisë. ☐ 3. Për inspektim të rastësishëm. ☒
2. Për verifikimin e zbatimit së detyrave të lëna. ☐ 4. Për rast incidenti ose aksidenti. ☐

• Për përshkrime të detajuara, aktit të inspektimit i bashkëlidhet një aneks shtesë A-1, si pjesë e tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE

Nr. Serial: 0000296

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. 11, datë 06.08.2018

Inspektorët e ISHMPU-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit fizik/juridik, "Erald Meta", në mbështetje të nenit 46 e vijim, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës 6/1 të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit", referuar shkeljeve të pasqyruara në Proces - verbalin e inspektimit me Nr. Serie 0001913, datë 06/08/2018, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

VENDOSA:

1. Të dënoj me Gjobë në vlerën : 500 000 lekë (Pesë qind mijë lekë)

☒ Të dënoj me "Paralajmërim", si dënim administrativ kryesor.

Një nga dy dënimet kryesore të mësipërme, si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtëme:

☒ Të pezullojë pjesërisht ose plotësisht aktivitetin:

☒ Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtëme:

☒ Të propozojë revokimin e lejes me Nr. Identifikimi _____, datë ____/____/____

☒ Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës ____.

☒ Të paguajë shpenzimet e analizave të mostrave në vlerën _____ lekë (.....)

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim drejtuar Komisionit të Ankimit të ISHMPU, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Ky vendimi mbahet në katër kopje.

INSPEKTORËT E AUTORIZUAR TË ISHMPU

1. Kejdi Ahmetaj; ID _____; ([Signature])
2. Arup Kelmaj; ID _____; ([Signature])
3. _____; ID _____; (_____)

(Emër, mbiemër, ID, nënshkrimi)

**NJOFTIM****Nr. 5981, datë 10.9.2018****PËR POZICIONIN E LIRË TË
SPECIALISTIT TË SEKRETARISË
GJYQËSORE NË KOMISIONIN E
PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton personat e interesuar të aplikojnë për pozicionin Specialist i Sekretarisë Gjyqësore në këtë institucion.

Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Specialistit të Sekretarisë Gjyqësore në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: IV-a

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në Drejtësi;
- b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- c) Të ketë të paktën tri vite përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);

Faqe|6

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 20 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–premtë, ora 08:30–17:00 ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

NJOFTIM**Nr. 5982, datë 10.9.2018****PËR POZICIONIN E LIRË TË
KËSHILLTARIT EKONOMIK NË
KOMISIONIN E PAVARUR TË
KUALIFIKIMIT**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton personat e interesuar të aplikojnë për pozicionin Këshilltar Ekonomik në këtë institucion.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ekonomik në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi me diplomë “master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për shkenca ekonomike, matematike ose në drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) Të zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze;

c) Të ketë shtatë vite përvojë pune në sektorin financiar.

Kushte të përgjithshme:



- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);

4. Dëshmi penalteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 20 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–premtë, ora 08:30–17:00 ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.